3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës	
Shtojca 2. Listat e Çmimeve të artikujve	
Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës	
Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial	
Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike.....	
Shtojca 6. Formulari Formulari i sasisë dhe Grafiku i lëvrimit.....	
Shtojca 7. Formulari. i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve.....	
Shtojca 8. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit	
Shtojca 9. Formulari i Njoftimit të Skualifikimit	
Shtojca 10. Formulari i Njoftimit të Fituesit	
Shtojca 11. Formulari i Njoftimit të Fituesit (Pas procesit të ankimit)	
Shtojca 12. Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kudër	
Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kudër (Pas procesit të ankimit)	

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit **Kontraktor [vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Mallrat për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontrates;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e lëvrimit dhe sasinë e kërkuar;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 7. Listat e Çmimeve të Artikujve.

-
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: _____

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Sasisë dhe grafikut për Mallrat duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për artikujt. Artikujt pa çmim do të konsiderohen si artikuj të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

1	2	3	4	6	
Artikulli	Përshkrimi i mallit	Sasia	cmimi per njesi	Çmimi total për artikull (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					

Çmimi total me TVSH:	
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[*Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik*]

[*Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [*Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor*]

Në emër të: [*Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar*]

* * *

Procedura e prokurimit [*lloji i procedurës*]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [*objekti*]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [*Data*] [*Numri*] / Nr. Referencës në faqen e APP-së

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [*emri i ofertuesit të siguruar*] ka derdhur një depozitë pranë [*emri dhe adresa e bankës*] / është garantuar pranë [*emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit*] me një vlerë prej [*monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra*] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kerkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [*njoftimin e kontratës*].

[**Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit**]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent". Skicimet, parametrat teknik etj

Specifikimet teknike të përgjithshme janë si më poshtë:

Bazuar në Ligjin Nr.10463, datë 22.9.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, Udhëzuesin Kombëtar të Administrimit të Sigurtë të Mbetjeve Spitalore, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 798, datë 29.09.2010 Për miratimin e rregullores “Për Administrimin e Mbetjeve Spitalore, si dhe në Ligjin Nr.8934 datë 05.09.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, VKM Nr.99 datë 18.02.2005 “Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve dhe në “Rregulloren e Brendshme të Administrimit të Mbetjeve Spitalore”, si dhe azhurnimeve përkatëse

Mbështetur në bazën ligjore të sipërcituar, Operatori Ekonomik do sigurojë furnizimin me materiale për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme spitalore, sipas specifikimeve të mëposhtme;

Emertimi	njesia	sasia
Qese të verdha Plastmasi per mbetje te rrezikshme spitalore, me vellim rreth 60-70 Lit, me logo dhe etikete te stampuar .	cope	16 710
Kontenitor te verdhe specifik per mbetje te mprehta spitalore ,me vellim 3 -3.5 lit Lit, me logo dhe etikete te stampuar .	cope	2 885
Kontenitor te verdhe specifik per mbetje te mprehta spitalore, me vellim 6.5-7 Lit, me logo dhe etikete te stampuar .	cope	1 167

1. Kërkesat e përgjithshme

Mbetjet spitalore duhet të vendosen në kontenierë që janë kundër rrjedhjeve, të papërshkueshëm ndaj lagështirës dhe të fortë për të parandaluar grisjen apo çarjen në kushte normale përdorimi. Këta kontenierë duhet të jenë një-përdorimsh dhe nuk duhet të ripërdoren. Ata duhet të jenë të tillë që të mbyllen në një mënyrë që mund të parandalojë derdhjen e përmbajtjes gjatë transportit. Kontenierët duhet të jenë në gjendje të mirë dhe të pa ndotur, të padëmtuar ose ndonjë defekt tjetër, që mund të dëmtojnë përdorimin e tyre të sigurt dhe të siguruar. Prodhuesi i mbetjeve duhet të kryejë inspektim vizual të këtyre kontenierëve për të përcaktuar gjendjen e tyre para se ata të përdoren.

2. Llojet e kontenierëve

Grupe të ndryshme të mbetjeve spitalore duhet të vendosen në llojet e duhura të kontenierëve. Para grumbullimit, të gjithë kontenierët duhet të jenë të mbyllur në mënyrë të sigurt dhe të lidhur si me poshte:

- **Mbyllja e kontenierëve**

Kontenierët e mbetjeve spitalore nuk duhet të mbushen mbi vijën paralajmëruese që tregon ndërmjet 70% dhe 80% të vëllimit të tyre maksimal para mbylljes. Ambalazhimi dhe mbyllja duhet të bëhen me kujdes për të siguruar që të mos mbetet asnjë mbetje spitalore në sipërfaqen e jashtme të kontenierëve. Kutitë e mbetjeve të mprehta duhet të mbyllen siç duhet me mbyllësin që kanë, ndërsa bidonat plastikë me mbyllësin e tyre ose natriban sipas rastit. Qeset plastike duhet të mbyllen duke iu lidhur grykën në mënyrë të sigurt për të parandaluar rrjedhjen

3. Etiketimi

Çdo kontenier i mbetjeve spitalore duhet të ketë një etiketë siç është specifikuar më poshtë. Etiketa duhet të fiksohet mirë ose të jetë e para-printuar në një pozicion të dallueshëm të kontenierit që lejon që të dhënat në etiketë të lexohen lehtë. Rekomandohet që kudo ku është e praktikueshme, të ngjitet ose para-printohet një etiketë në secilën nga anët e kundërta të kontenierëve. Etiketa e mbetjeve duhet të plotësohet saktë dhe qartë




Përveç kësaj, çdo kontenier duhet të shënohet duke përdorur bojë të zezë që nuk fshihet ose t'i ngjitet mirë një etiketë, për të treguar origjinën e mbetjeve (p.sh. emrin dhe adresën e prodhuesit të mbetjeve) dhe datën e mbylljes. Në qoftë se një mbajtës qese (p.sh. një kosh i zakonshëm për mbetje) përdoret për mbajtjen e qeses plastike që është në përdorim, ai duhet të jetë në gjendje të mirë dhe duhet të ndjekë të njëjtat kërkesa për etiketimin si për vetë qesen plastike. Ngjyra e mbajtësit të qeses preferohet të jetë e njëjtë me atë të qeses për identifikim të lehtë.

PËRMASAT E ETIKETES

Tipi i kontenierit	Përmasat e etiketës
Kontenier për të mprehtat me kapacitet prej më pak se 2 litra	jo më pak se 40 mm x 40 mm
Kontenier për të mprehtat me kapacitet prej 2 litra ose më shumë	jo më pak se 75 mm x 75 mm
Kontenierë të tjerë	jo më pak se 150 mm x 150 mm

SIMBOLI NË ETIKETË



Specifikimet e simbolit:

Ngjyrat e simbolit duhet të jenë si më poshtë:

Konturet – e zezë

Fusha – e bardhë ose ngjyra parësore e kontenierit

Fjalët dhe karakteret – e zezë

Shenja ndërkombëtare e Biohazardit – e zezë

SPECIFIKIMET PËR KONTENIERËT E MBETJEVE SPITALORE

Specifikimet për tipe të ndryshme të kontenierëve për mbetjet spitalore të cilat bazohen në Udhëzuesin kombëtar të publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë.

1. Kuti për të mprehtat

- Në përputhje me *standardin Britanik BS 7320:1990* në lidhje me rezistencën ndaj depërtimit dhe rezistencën ndaj rrjedhjes pas rënie vertikale dhe përmbysjes ose specifikime të ngjashme për konteinerët e mbetjeve infektive;
- Hapja duhet të jetë aq e gjerë sa të lejojë materialet e asgjësueshme të hidhen në kontenier duke vepruar vetëm me një dorë. Në varësi nga masa e materialit të asgjësueshëm për të cilën është projektuar kontenieri i veçantë, hapja duhet, në kushte normale të përdorimit, të pengojë heqjen e përmbajtjes;
- Nëse janë të përfshira kapakë të lëvizshëm, ato duhet të jenë të projektuara në mënyrë të tillë që nuk është kurrë e nevojshme për të shtyrë materialet në kontenier me dorë;
- Kontenieri duhet të jetë i tillë që të mbyllet në mënyrë të sigurt dhe të mbetet i mbyllur gjatë transportit;
- Pasi janë mbyllur, të gjitha llojet e kontenierëve duhet të mos lejojnë rrjedhje;
- Kur është e mundur, të jetë i pajisur me një dorezë që nuk është pjesë e pajisjes mbyllëse;
- Të ndezshme dhe të afta për t'u djegur në mënyrë të sigurtë dhe nuk duhet të përbëhet nga polivinilkloridi (PVC);
- Të jetë e shënuar në mënyrë të dukshme me një vijë horizontale për të treguar kur kutia e të mprehtave është e mbushur ndërmjet 70% dhe 80% të vëllimit të saj maksimal, së bashku me fjalët "KUJDES - MOS E MBUSHNI MBI VIJË";
- Me ngjyrë të verdhë apo kombinim i të bardhës dhe të verdhës; dhe për të mprehtat e ndotura nga citotoksikë, me ngjyrë të purpurt me simbolin e mbetjeve citotoksike;
- E tillë që në të mund të shkruhet me bojë që nuk fshihet dhe të ngjitet në mënyrë të sigurt etiketa. Të etiketohet qartë me fjalët "Rrezik: Të mprehta të ndotura" dhe duhet të përmbajë simbolin e biohazardit në etiketë.

2. Qeset plastike për punë të rëndë

Qese plastike për grumbullimin dhe ruajtjen e mbetjeve spitalore dhe mbetjet e lidhura me to, përveç mbetjeve të mprehta.

- Të kenë rezistencë të mjaftueshme për të mbajtur në mënyrë të sigurtë klasën e mbetjeve për të cilat ato janë caktuar;
- Me një kapacitet maksimal nominal prej 0.1 m³;
- Me trashësi minimale prej 150 mikron nëse janë prodhuar nga polietilen me dendësi të ulët, ose 75 mikron nëse janë prodhuar nga polietilen me dendësi të lartë ose polipropilene dhe nuk duhet të prodhohen nga polivinilkloridi (PVC);

- Të përmasave dhe formës së përshtatshme për t'ju përshtatur mbajtësve të qeseve në përdorim;
- Të jetë e shënuar në mënyrë të dukshme me një vijë horizontale për të treguar kur kutia e të mprehtave është e mbushur ndërmjet 70% dhe 80% të vëllimit të saj maksimal, së bashku me fjalët "KUJDES - MOS E MBUSHNI MBI VIJË";
- Nuk duhet që të sigurohet me kapse ose me pajisje të tjera mbyllëse me dalje të mprehtë.
- Me ngjyra të verdhë për mbetjet spitalore;
- E tillë që në të mund të shkruhet me bojë që nuk fshihet dhe të ngjitet në mënyrë të sigurt etiketa.

3. Miratimi i llojit të kontenierëve të mbetjeve

Furnizuesit e kontenierëve duhet të pyeten nëse kontenieri është "Lloj i miratuar" për mbetje spitalore. Miratimi i BE-së i llojit është një standard ndërkombëtar dhe kontenierët e prodhuar dhe testuar në vende të tjera do të pranohen me kusht që miratimi i llojit është i gjurmueshëm në një qendër të caktuar të përshtatshme.

Kodi i miratimit normalisht stampohet mbi kontenier gjatë prodhimit.

Një kod tipik në një lloj të miratuar kontenieri në BE është p.sh.: 1H2/Y1/S/02/GB/4532.

Shifra e parë "1" identifikon llojin e kontenierit: 1 = kosh, 2 = fuçi, 3 = bidon, 4 = kuti; 5 = qese.

Germa "H" tregon materialin e ndërtimit: A = çelik; H = plastike.

Shifra "2" ka të bëjë me përmasat e hapjes: 1 = më pak se 7 cm (me kapak të hequr), 2 = më shumë se 7 cm.

Y1 = grupin e ambalazhit.

S = të ngurta; L = të lëngshme.

02 = data e prodhimit.

GB = vendi i prodhimit p.sh. Britania e Madhe.

4532 = kodi individual i ambalazhit për çdo produkt.

Gjithashtu, mund të përdoren kontenierë të kombinuar p.sh. një lloj i miratuar në BE i qeses së verdhë që vesh një kontenier të ngurtë, por që duhet të jenë testuar më parë si një njësi e kombinuar dhe të kenë marrë miratimin vetëm për përdorim si të tillë.

Institucionet shëndetësore duhet të sigurohen që përdorin kontenierët e duhur për secilin lloj mbetjesh – kontenierët e çertifikuar P621, IBC620 ose LP621 për mbetjet spitalore, ose UN2814 ose UN2900 për mallra farmaceutike dhe mallra të tjera të rrezikshme.

Në mënyrë të ngjashme, qeset e verdha dhe kazanët e asgjësueshëm mund të transportohen në kazanë me rrota, por kur kazani ka një kapacitet më të vogël se 450 litra/400 kg, duhet të jenë të testuar si një paketë e kombinuar. Kur kazani ka një kapacitet më të madh se 450 litra/400 kg, atëherë brenda tij mund të përdoret çdo kontenier i miratuar në BE.

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Afatet e lëvrimit:

Emertimi	njesia	sasia	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
Qese të verdha Plastmasi per mbetje te rrezikshme spitalore, me vellim rreth 60-70 Lit, me logo dhe etikete te stampuar .	cope	16 710	SRSH	12 muaj nga nenshkrimi i kontrates
Kontenitor te verdhe specifik per mbetje te mprehta spitalore ,me vellim 3 -3.5 lit Lit, me logo dhe etikete te stampuar .	cope	2 885	SRSH	12 muaj nga nenshkrimi i kontrates
Kontenitor te verdhe specifik per mbetje te mprehta spitalore, me vellim 6.5-7 Lit, me logo dhe etikete te stampuar .	cope	1 167	SRSH	12 muaj nga nenshkrimi i kontrates

Afati lëvrimit: Ky fond mbulon nevojat për 12 muaj nga lidhja e marrëveshjes kuadër.

Për çdo kontratë të lidhur brenda marrëveshjes kuadër:

- 30% e sasisë për çdo artikull duhet të lëvrohet brenda 15 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës, pjesa e sasisë së mbetur duhet të lëvrohet deri në përfundim të kontratës dhe sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor.

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- d) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- e) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- f) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- g) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë perfshire muajin Korrik 2022.
- h) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- i) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- j) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- k) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- l) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

b. Lista e cmimeve të artikujve, sipas shtojcës 2;

c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

ç. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllëgaritur të kontratës me afat vlefshmerie 150 dite.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- a) Kopje të çertifikuara/vërtetuara të **balanceve për vitet 2019,2020,2021** të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse tatimore, të konfirmuara nga ky autoritet. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.
- b) Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin **vërtetim për xhiron vjetore të tre viteve të fundit** nga data e shpalljes së

njoftimit te kontrates(**2019,2020,2021**) ku vlere e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% fondit limit te vlerës së përllogaritur të kontratës për të cilin konkurron..Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas shtojces 8

2.3. Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë **dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme**, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlere, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të **deklaruar në organet tatimore**, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të disponojë certifikatat e mëposhtme në lidhje me mallra objekt prokurimi duhet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

a) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese certifikatën **ISO 9001:2015** mbi **“Sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalent**, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise.

b) Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese certifikatën **ISO 14001:2015** mbi **“Sistemet e menaxhimit të ambjentit” ose ekuivalent**, në përputhje me objektin e prokurimit, lëshuar nga një organ i vleresimit te konformitetit, i akredituar nga organizmi kombetar i akreditimit ose nga organizma nderkombetare akreditues, te njohur nga Republika e Shqiperise.

AK rezervon te drejten per verifikimin e vetedeklarimit ne procesin e vleresimit te dokumentacionit dhe ne rastin kur OE ofertues shpallet fitues, duhet te paraqese certifikaten ne fjale.

2.3.3. Operatorët ekonomik duhet te kenë te perfshire ne QKB objektin e prokurimit.

2.3.4. OE duhet të paraqesin:

Per çdo artikull objekt prokurimi, ofertuesi duhet të paraqesë mostra në ditën e hapjes/dorëzimit të ofertave, me datë **10.10.2022** në orën **10:00**. Dorëzimi i Kampioneve/mostrave, të bëhet pranë Sektorit të Prokurimeve, Spitalit Rajonal Shkodër, të mbyllura në një zarf /kuti jo transparente të vëlosur mbi të cilin të shënohet:

- “Mos e hapni me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të procedurës së prokurimit « **Blerje materiale të ndryshme për mbetjet e rrezikshme spitalore për 12 Muaj» dhe jo para datës 10.10.2022, ora 10:00** (*Data e hapjes/dorëzimit të Ofertave).
- Se bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkresë të vëlosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf/kuti.
- Mbi çdo mostër të dorëzuar, ofertuesi duhet të shënojë Nr. Rendor të Artikullit që përfaqëson sipas formularit të çmimit.
- Në paketimin e çdo mostre duhet të evidentohet qarte origjina e mallit, e cila duhet të përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi.

Nëse mostrat e dorëzuara, nuk janë të shoqëruara me listën e inventarizimit dhe të identifikuar sipas Nr. Rendor të formularit të çmimit, nëse ka mundësi mostrash për artikuj të veçantë ose nëse origjina e stampuar mbi mostër nuk përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi, atëherë oferta do të quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do të s’kualifikohet.

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera një mjet për transportin e mallrave deri në destinacionin e kërkuar (Spitali Rajonal Shkodër).

Për mjetin në pronësi duhet të paraqesë:

1. Certifikatë e pronësisë
 2. Lejet e qarkullimit
 3. Certifikatë e kontrollit teknik
 4. Policën e sigurimit të mjetit
 5. Taksat
- Për mjetin me qera duhet të paraqesë:

1. Kontrate qeraje origjinale e noterizuar apo huapërdorje e vlefshme për periudhën e zbatimit të kontratës shoqëruar me certifikatën e pronësisë
2. Lejet e qarkullimit
3. Certifikatë e kontrollit teknik
4. Policën e sigurimit të mjetit
5. Taksat

Për plotësimin e kësaj kërkesë operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë mjetin e mësipërm në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8, ndërsa **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit** duhet të dorëzojë për mjetin e sipërcituar dokumentacionin e lart përmendur.

Shtojca 8.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I, Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I:**Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik**

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik

(nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Deklaroj se, për subjektin / subjektet në kapacitetin/et, e të cilit/ëve do të mbështetem, nuk ka arsye për skualifikimin ose përjashtimin e tij / tyre nga procedura, në përputhje me dispozitat e nenit 76 të LPP-së, dhe konfirmoj me dokumente provuese që do të ketë burimet e kërkuara siç janë deklaruar.

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata	Referencat (kur janë të zbatueshme)
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: etj.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]]

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP- .	
Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi, përfshirë legjislacionin mjedisor, social dhe të punës.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]
Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së. Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.	Nëse dokumentacioni përkatës është i disponueshëm në formë elektronike, ju lutemi tregoni: Adresën e ueb-it: [shkruajeni] Autoritetin ose organin lëshues: [shkruajeni] Lloji i dokumentit: [shkruajeni]

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, bëj këtë deklaratë në përputhje me nenin 1 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", dhe në zbatim të Ligjit Nr. 9121/2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", dhe garantoj që deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:	
1. Kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj deklarate;	Po []
2. Kuptoj që oferta e paraqitur do të skualifikohet dhe / ose përjashtohet nga pjesëmarrja në prokurimin publik nëse kjo Deklaratë konstatohet se nuk është e plotë dhe / ose e pasaktë në të gjitha aspektet;	Po []
3. Jam i autorizuar nga Ofertuesi për të nënshkruar këtë Deklaratë dhe për të paraqitur një Ofertë në emër të Ofertuesit;	Po []
4. Çdo person, nënshkrimi i të cilit paraqitet në dokumentacionin e ofertës është i autorizuar nga ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në emër të ofertuesit;	Po []
5. Për efekt të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë e kuptoj se fjala "konkurrent" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, përveç Ofertuesit, pavarësisht nëse paraqitet si një bashkim i operatorëve ekonomikë ose jo, që:	Po []

a) paraqet një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është ofertues i mundshëm i cili, bazuar në kualifikimet, aftësitë ose përvojat e tij, mund të paraqesë një Ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës .	
6. Ofertuesi deklaron se e ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, komunikuar dhe pa pasur ndonjë marrëveshje ose dakord me ndonjë konkurrent tjetër;	Po [] Jo []
7. Ofertuesi deklaron se është konsultuar, ka komunikuar, ka lidhur marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet e bashkangjitura, detajet e kësaj oferte përfshijnë emrat e konkurrentëve, natyrën dhe arsyet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes ose angazhimit (në rast të një bashkimi të operatorëve ekonomikë ose nën-kontraktimit).	Po [] Jo []
8. Në veçanti, pa cenuar pikat 6 dhe 7 më lart, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, kontratë ose marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me : a) çmimet; b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit; c) qëllimin ose vendimin për të	Po [] Jo []

paraqitur një ofertë ose jo; ose d) paraqitjen e një oferte që nuk plotëson specifikimet e kërkesës së ofertës.	
9. Për më tepër, nuk ka pasur asnjë konsultim, komunikim, marrëveshje ose kontratë me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet ose dërgesat specifike të mallrave ose shërbimeve në lidhje me prokurimin përkatës, përveç kur thuhet në pikën 7 më lart.	Po [] Jo []
10. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të ditura ose treguar ofertuesve të tjerë në asnjë mënyrë, qoftë para datës dhe orës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes së ofertës fituese dhe nënshkrimit të kontratës, përveç nëse kërkohet nga ligji ose nëse thuhet specifikisht nën pikën 7 më lart.	Po [] Jo []

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon: Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.
Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

